

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë, përmes gjyqtares së vetme Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në çështjen penale kundër të akuzuarit XH.K. nga K. Kamenicës, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nen par. 2 dhe shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 para. 1 të KPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PPK-së nga Gjilani PP.nr.365/2012 të dt.12.03.2012, në shqyrtimin e hapur gjyqësor, më dt.23.09.2015 komunikoi, ndërsa më dt.30.09.2015 përpiloi këtë.

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

I akuzuari XH.K. pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga, „data e lindjes,, ... , K. e Kamenicës,

Në pajtim të nenit 364 parag. 1 nën parag. 1.3 I KPPRK-së,

Lirohet nga akuza

I

Më datën 19.05.2011, në, K. Kamenicës, i pandehuri me qëllim të përfitimit pasuror për vete, pa dokumentacion përkatës valid ka shfrytëzuar-seperuar lëndë minerale rërë dhe zhavorr, në sasi prej 3,421.631 m³, në vlerën të pa përcaktuar, dhe në këtë mënyrë e ka dëmtuar Buxhetin e Kosovës.

- me çka kishte për të kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 parag. 1 nen para. 2 të KPK-së.

II.

Në ditën , kohën dhe vendin , si në dispozitivin I të kësaj aktakuze, i pandehuri ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve , në atë mënyrë që duke bërë shfrytëzimin ,

pastrimin , seperimin ilegal të lëndës minerale rërës dhe zhavorrit, ka krijuar rreziqe për banorët e kësaj treve-hapësirat ku janë nxjerrë mineralet janë mbushur me ujë dhe rrezikojnë fëmijët.

- me çka kishte për të kryer veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 parag. 1 të KPK-së

E dëmtuara KPMM-ja në Prishtinë për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve bugjetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike komunale në Gjilan, me aktakuzën PP.nr.365/2012 prej datës 12.03.2012, ka akuzuar XH.K. nga f.sh., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 nën par. 2 dhe shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par. 1 të KPK-së, pranë të cilës akuzë ka mbetur edhe në fjalën përfundimtare me propozim që i akuzuari të deklarohet fajtor dhe të dënohet në përputhje me ligjin, duke i propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr parasysh rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese.

Përfaqësuesi me autorizim i të dëmtuarës KPMM-së ju është bashkangjitur ndjekjes penale dhe parashtrori kërkesë pasurore juridike.

I akuzuari XH.K. gjatë paraqitjes së mbrojtjes nuk ka kontestuar faktin se në vitin 2011 ka shfrytëzuar rërë dhe zhavorr pa qenë i pajisur me licencë të shfrytëzimit dhe me leje për aktivitete të veçanta nga KPMM-ja, mirëpo mohon në tërësi veprat penale për të cilat është akuzuar duke sqaruar se shfrytëzimi i rërës dhe zhavorrit është bërë në pronë private e jo në pronë të huaj, gjithashtu ka poseduar lejen nga komuna dhe pëlqimin nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i akuzuari deklaroi se ka aplikuar për tu pajisur me dokumente–licencë nga KPMM-ja mirëpo në momentin e inspektimit nuk i ka përfunduar procedurat për tu pajisur me licencë, për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit ka paguar taksa komunale, vendpunimi ka qenë i thurën me rrethoj teli, shtëpitë nga vendpunimi kanë qenë larg mbi një km, gropat e hapura janë mbyllur pas përfundimit të punëve – brenda muajit. Në fjalën përfundimtare nuk e ndien veten fajtor për veprat penale për të cilat akuzohet për këtë kërkon nga gjykata që

shqyrtoj sa më drejt të gjitha provat që disponon e të merr një vendim meritor ta liroj nga përgjegjësia penale

Gjykata, ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarit , ka shqyrtuar të gjitha provat një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën , dhe ka konstatuar këtë gjendje të fakteve:

Nuk kontestohet nga askush , se i akuzuari kishte ushtruar veprimtarinë e tij biznesore pa pasur licencë pune për një veprimtari të tillë , këtë nuk e konteston as i akuzuari as përfaqësuesi i akuzës. Mirëpo fakti se i akuzuari kishte ushtruar biznes pa licencë pune , vetvetiu nuk nënkupton se ai ka konsumuar edhe veprat penale të cilat me akuzën e prokurorit të shtetit i vihen në ngarkesë. Përfaqësuesi i akuzës me asnjë provë nuk ja ka arritur t'i dëshmojë me prova të sigurta pretendimet e t'ia, për arsye si më poshtë:

1. Së pari figura e veprës penale të vjedhjes qëndron në përvetësimin e sendit të huaj të luajtshëm, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme dhe vepra konsiderohet e konsumuar kur pronari-poseduesi zhvishet nga posedimi i sendit në mënyrë të kundërligjshëm dhe mbi të vë pushtetin faktik kryesi, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme, në rastin konkret asnjë nga elementet të veprës penale nuk janë përmbushur , i akuzuari ka shfrytëzuar pasurinë e tij e jo të tjetrit edhe pse në mënyrë të kundërligjshme , mirëpo jo çdo shkelje e ligjit paraqet vepër penale , në rastin konkret nuk është përmbushur asnjë nga elementet e veprës penale të vjedhjes. Pronare e parcelës nuk është Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale por i akuzuari dhe si ka mundur ai ta vjedh pasurinë e vet !!! E drejta e pronës është e drejtë absolute e pronarit dhe ai e shfrytëzon atë si ai e konsideron të dobishme për të , nënkuptohet në koherencë me ligjin, për veprimtari të caktuara. Pasurit nëntokësore janë të mira të përgjithshme , por në situata të tilla shpallet interesi i përgjithshëm publik, bëhet shpronësimi dhe toka kalon në pronësi të shtetit , këtu nuk ka ndodhë kjo situatë dhe vërtetë është e paqartë , si përfaqësuesi i akuzës ka ngritur një çështje të tillë. Nga rezoni i përfaqësuesit të akuzës po rezulton se i akuzuari po të kishte licencë pune s'do kishte vjedhje , vepra penale e vjedhjes nuk lidhet me licencën e punës, ngase i akuzuari nuk ka vjedhë sendin e huaj të kundërligjshëm ka shfrytëzuar resurset nga prona e tij , s'do mend pa leje përkatëse .

2. Së dyti vepra penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm si vepër penale kundër sigurisë të njerëzve dhe pasurisë, konsumohet kur kryesi , me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve, eksplozivit, helmit, gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, me energji elektrike ose me energji të çfarëdo lloji shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo pasurinë e një

rëndësie thelbësore .Në rastin konkret asnjë nga këto veprime alternative të mundshme nuk janë të pranishme, nëse përfaqësuesi ka menduar në krijimin e gropave atëherë kjo alternativë bie në “ veprim tjetër të rrezikshëm” që neni 291 nuk e kishte, për dallim që këtë formë alternative të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm e përmban neni 365 i Kodit aktual dhe e ish LPK-së. Përshkrimi faktik i veprës penale në dispozitivin nën II. nuk përmban asnjë element të kësaj vepre penale, përpos një konstatimi “si në dispozitivin nën I.” duke bërë shfrytëzimin, pastrimin, seperimin ilegal të lëndës minerale rërës dhe zhavorrit ka shkaktuar rrezik për jetën e njerëzve “!!!! , nga ky konstatim po rezulton se me vet faktin se i akuzuari paska shfrytëzuar zhavorrin pa licencë, paska rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurisë. Edhe nën supozimin se norma ligjore e nenit 291 të KPK –së, i sanksiononte edhe veprimet tjera të rrezikshme (siç i sanksionon neni 365 i KPK i tanishëm”, duhet të bëhet fjalë për rrezik konkret jo rrezik abstrakt , d.m.th. prokurori do duhej saktë ta përshkruante veprimin e rrezikshëm ; sa ishin dimensionet e asaj hapje(grope), gjerësia , thellësia, lokacioni (a kishin qasje në atë rrugë dhe afër asaj njerëzit , kafshët) asnjë nga këto elemente nuk janë përshkruar në dispozitiv dhe as që ekzistojnë , andaj në rrethana të këtilla nuk mund të thuhet se është vepruar në kundërshtim me neni 291 të KPK-s, për vet faktin se nuk posedonte licencë për eksploatimin e zhavorrit .

Kryesi mund me një veprim të konsumoj disa vepra penale të ndryshme (bashkimi ideal heterogjen) ose me shumë veprime të konsumoj disa vepra penale të ndryshme (bashkimi real heterogjen) , mirëpo nuk është e mundur që veprimet krejtësisht të njëjta, të vihen nën tri norma që u përkasin gjinive të ndryshme (genuseve të ndryshme) : e para vepra penale kundër pasurisë, e dyta kundër sigurisë. Krejt ngjarja që prokurori e konsideron veprim kriminal penal, konsiston në shfrytëzimin e zhavorrit pa licencë të nevojshëm dhe ky është veprimi kryerës së veprave penale të pretenduara, pavarësisht se në dy dispozita të ndara, prokurori ka parafrazuar nga një fjali që i përket veprës penale përkatëse ,mirëpo realisht kemi të bëjmë vetëm me një veprim – puna pa licencë .

Gjykata vlerësoi edhe dëshmitë e dëshmitarëve dhe përfaqësuesit të të dëmtuarës që janë dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor , mirëpo ata me dëshmitë e tyre vetëm kanë dëshmuar se i pandehuri po zhvillonte afarizëm pa licencë dhe asgjë më tepër (ngase bazuar në çështjen penale që ishte objekt akuze -causa kriminalis) vjedhja e rëndë dhe shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm dëshmitë e tyre nuk kishin të bënin me këto çështje, ndërsa u tha më sipër fakti se i akuzuari zhvillonte afarizëm pa licencë nuk është kontestuese.

Në rrethana të këtilla , siç u paraqitën më lartë, nuk dalin të provuara asnjë nga tezat e akuzës dhe me asnjë provë nuk është dëshmuar se i akuzuari ka kryer veprat penale , për të cilat është akuzuar dhe për këtë arsye, në kuptim të nenit 364.pika 1. 3 të KPPK-s , u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

E dëmtuara KPMM-ja në Prishtinë për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Për shpenzimet e procedurës penale gjykata ka vendosur që ato të bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, në kuptim të nenit 454 parag. 1 i KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN- DEGA NE KAMENICE,

Më datën 30.09.2015.

Sekretarja juridike,

Emine Zubaku,d.v.

Gj y q t a r j a,

Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.